09

Konfirmohet
Evangjelo Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 11043 Prot

Lushnje, më 15.12.2025

RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK
KËTU

"MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE TË BUXHETIT VJETOR TË BASHKISË LUSHNJE"

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Bazuar ne ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" **neni 33 pika 2, ku citohet se:**

"2.Kalendari miratohet nga Këshilli i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore jo më vonë se data 31 dhjetor dhe hyn në fuqi në ditën e parë të çdo viti buxhetor"

Në vitet më parë kalendari është miratuar bashkë me PBA-në. Duke qënë se Kalendari nuk përbën Akt –Normativ duhet të miratohet vendim më vete dhe nuk dërgohet në prefekturë.

Kërkojmë nga ju miratimin e Kalendarit sipas tabelës bashkëlidhur.

Për Drejtorinë e Fianacë –Buxhetit
Juljana Hasalla
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë Jurdike
Enejd Dhamo

BASHKIA LUSHNJE

Kalendari i përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm dhe i Buxhetit Vjetor . Viti 2026

PERIUDHA	DATA	INSTITUCIONI/PERSONI PËRGJEGJËS	VEPRIMI PERKATES
Dhjetor	Brenda muajt dhjetor	Kryetari i NJQV-së	Përgatit dhe paraqet në Këshillin Bashkiak Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe te buxhetit vjetor.
Dhjetor	Deri - 31 Dhjetor	Këshilli i Njësisë Vendore	Shqyrton dhe miraton Kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe te buxhetit vjetor
Janar	15	Kryetari i NJQV-së	Kryetari shpërndan kalendarin e programit buxhetor afatmesëm tek të gjitha njësitë shpenzuese
Janar	31	Kryetari i NJQV-së	Kryetari i njësisë paraqet për shqyrtim dhe miratim raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
Shkurt	Brënda muajit	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë	Dërgon Udhëzimin vjetor për përgatitjen e buxhetit vendor
Mars	Jo me vone se 1 Mars	Këshilli i Njësisë Vendore	Miraton raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave
Mars	Brenda dates 15	Kryetari i NJQV-së	Paraqet për miratim në Këshillin e NJQV-së tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA ne nivel programi
Mars	15	Këshilli i Njësisë Vendore	Miraton tavanet përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm
Mars	20	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin e përgatitjes së buxhetit të njesisë së vetëqeverisjes vendore dhe e shpërndan tek njesitë shpenzuese
Mars - Prill	21 Mars -27 Prill	Njesite shpenzuese të bashkisë	Përgatisin kërkesat e tyre buxhetore mbi bazen e tavaneve praprake
Mars - Prill	28 Prill - 30 Prill	Njësitë shpenzuese të Bashkisë	Njësitë shpenzuese paraqesin në bashki kërkesat e përgatitura
Maj	1 Maj - 15 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave buxhetore
Maj	16 Maj - 20 Maj	Kryetari i NJQV-së	Diskuton me GMS-në dhe EMP-në propozimin fillestar te shperndarjes se tavaneve per çdo program
Maj	21 Maj - 31 Maj	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Përpilon draftin e fazës së parë të PBA-së 2027-2029
Qershor	1	Kryetari i NJQV-së	Dërgon pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri - 20	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë	Dërgon një raport me mendime mbi projektdokumentin e programit buxhetor afatmesëm
Qershor	Deri -25	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Reflekton komentet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
Qershor	Deri - 30	Këshilli i Njësisë Vendore	Shqyrton dhe miraton projektin e parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 5 Korrik	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	Deri - 10 Korrik	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë	Dërgon Udhëzimin plotësues për përgatitjen e buxhetit vendor
Korrik	Deri - 20 Korrik	Këshilli i Njësisë Vendore	Miraton tavanet përfundimtare të programit buxhetor afatmesëm
Korrik	25	Kryetari i NJQV-së	Miraton udhëzimin plotësues të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm dhe shpërndan tek njësitë shpenzuese
Korrik - Gusht	26 Korrik-15 Gusht	Njësitë shpenzuese të bashkisë	Përgatisin dhe paraqesin kërkesat buxhetore të rishikuara, në përputhje me tavanet përfundimtare.
Gusht	16-31	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Kryejnë analizat e kërkesave të rishikuara buxhetore dhe publikon programin buxhetor afatmesem te rishikuar
Shtator	1-14 Shtator	Kryetari i NJQV-së	Organizon seanca degjimore me komunitetin dhe grupet e interesit
Shtator	Deri - 15	Kryetari i NJQV-së	Dërgon në Ministrinë e Financave dokumentin e programit buxhetor afatmesëm të rishikuar te miratuar nga keshilli i njësisë bashke me informacionin mbi rekomandimet e dhena nga MFE gjate fazes se pare.
Shtator-Tetor	Deri 5 Tetor	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë	Organizohen seanca konsultimi me njësitë e vetëqeverijses vendore
Tetor	Deri - 20 Tetor	Ministria e Financave dhe e Ekonomisë	Sipas rastit, Ministria e Financave dërgon mendimet përfundimtare për t`u reflektuar në dokumentin final të PBA
Tetor-Nentor	20 Tetor -30 Nentor	Njësia përgjegjëse për buxhetin në bashki	Përgatit Projektbuxhetin e vitit 2027 si dhe, dokumentin e rishikuar të PBA 2027-2029 dhe i paraqet për shqyrtim ne Këshill.
Dhjetor	25	Këshilli i njësisë vendore	Miraton programin buxhetor afatmesëm përfundimtar dhe buxhetin vjetor
Dhjetor	31	Kryetari i NJQV-së	Merr masat për publikimin dokumentin e plotë të programit buxhetor afatmesëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 11048/1 Prot

Lushnje, më 15.12 2025

PROJEKT –VENDIM

Nr 114 Datë 15 12.2025

"MBI MIRATIMIN E KALENDARIT TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE TË BUXHETIT VJETOR TË BASHKISË LUSHNJE"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës _____ 2025, pasi analizoi relacionin "*Mbi miratimin e Kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit Vjetor*", si dhe në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 *"Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar*, **Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33 pika 2,** Ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republiken e Shqiperise" i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore"

Propozojmë :

1. Të miratojë kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor sipas pasqyrës bashkalidhur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen të gjitha drejtoritë dhe strukturat e Bashkisë Lushnje dhe Ndërmarrjet Vartëse.

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Për Drejtorinë e Fianacë –Buxhetit
Juljana Hasalla
Ervisa Çuko

Për Drejtorinë Jurdike
Enejd Dhamo

KRYETAR I BASHKISË
ERISLEDA SEFA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE